

MODULI
“DREJTIMI PEDAGOGJIK
MBËSHTETUR
NË TË DHËNA”

DR ERALDA ZHILLA



5 SEANCA 3 ORE SECILA


- **Seanca 1:** Njohje me metodat kryesore te studimit bazuar në te dhena cilësore dhe sasiore. Leximi dhe analizimi i të dhënave të ndryshme.
- **Seanca 2:** Tipe të ndryshme instrumentash për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore
- **Seanca 3:** Përkufizimi i problemeve të ndryshme në shkollë dhe paraqitja e tyre në bazë të dhënash sipas nevojave. Formulimi i një plani ndërhyrjeje bazuar në të dhënat e mbledhura.
- **Seanca 4:** Analiza e bazës së të dhënave sipas nevojave dhe kërkesave specifike që ka shkolla. (metoda eksploruese, përshkruese dhe shpjeguese)
- **Seanca 5:** Përdorimi i bazës së të dhënave për të hartuar raporte specifike, për të identifikuar probleme, për të nxjerrë përgjigje sipas nevojave të shkollës.

DISKUTIM.....

- Të dhënat bazë që siguron sot shkolla.....



TEMA 1 – NJOHJE ME METODAT KRYESORE



Çështja 1 - “Kur duhet të mbledh të dhëna rreth një fenomeni të caktuar në shkollë, unë zgjedh.....”

Çështja 2 – Në opinionin tuaj, cili është problemi më i rëndësishëm me të cilin përballet shkolla juaj sot, gjë që ti e ke zbuluar me të dhënat që ke grumbulluar?

Çështja 3 – Nëse do të kisha këtë problem (.....) në shkollën time, si do e masja atë? Si do e studioja dhe eksploroja?



Përcaktimi problem

Qëllimi

Përcaktojmë qëllimin përse ne duam të masim apo të studiojmë një fenomen/ dukuri në shkollë

Plani veprimit

- Ne ndërtojmë një plan pune
- Identifikojmë rrugën dhe mënyrën
- Zgjedhin fushën ku do fokusohemi
- Zgjedhim metodën më të përshtatshme që i vjen në ndihmë qëllimit primar.

Përse është i rëndësishëm

Kujt do i shërbejë ajo që ne bëjmë?
Përse më duhen ato të dhëna?
Si mund ti përdor sërish?
Si mund ti përgjithësoj rezultatet?

ROLI I PUNËS KËRKIMORE NE ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE NË SHKOLLË PËRMES PESË HAPAVE



MODELI ME 7 HAPA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

- *1. Identifikimi i problemit: Cili është problem/sfida?*
- 2. Përcaktimi i objektivave: çfarë dua të arrij?*
- 3. Gjetja e alternativave: çfarë mund të bëj për të arritur qëllimin?*
- 4. Shqyrtimi i pasojave: Cilat janë pro & kundra?*
- 5. Marrja e vendimit: çfarë duhet të bëj?*
- 6. Implementimi: Koha për të vepruar!*
- 7. Vlerësimi: çfarë funksionoi dhe çfarë jo?*

- Cdo studim i përmbahet një strukture të përcaktuar më parë. Në bazë të saj orientohet më pas e gjithë puna. Cilat janë shtyllat kryesore ku duhet të mbështetemi?
 1. Përcaktojmë qëllimin – pse duhet të kryhet ky studim? Kush janë pjesëmarrësit? Cila është popullata e interesuar? Cilat çështje duhen trajtuar?
 2. Vlerësojmë burimet – cilat janë burimet e nevojshme për këtë studim? Cilat burime personale do përdorni për studimin?
 3. Zgjedhim metodën – zgjedhim atë metodë që është më e përshtatshme për qëllimin.
 4. Ndërtojmë instrumentin – përcaktojmë pyetjet që duam t'i përgjigjemi. Japim disa përgjigje alternative për respondentët, nga të cilat ata duhet të zgjedhin atë që i përshtatet më shumë. Ndërtojmë strukturën finale të pyetëtorit.
 5. Zhvillojmë fazën pilot – testojmë pyetëtorin në një pjesë të popullatës. Vlerësojmë pyetëtorin dhe i japim formën përfundimtare.
 6. Zgjedhim kampionin – përcaktojmë mënyrën e kampionimit dhe burimet që kemi.
 7. Trajnimi i intervistuesve
 8. Mbledhim të dhënat
 9. Analizojmë të dhënat
 10. Interpretojmë dhe diskutojmë rezultatet
 11. Japim rekomandimet përkatëse

USHTRIM 1

- **Zhvillimi i vizionit dhe i strategjisë për përmirësimin, planifikimin dhe për vlerësimin e arritjeve të institucionit arsimor**
- **Drejtimi në ekip për zbatimin e kurrikulës, mësimdhënies dhe të nxënit të suksesshëm**
- **Menaxhimi efektiv i njerëzve, burimeve dhe i financave**
- **Drejtimi i ndryshimeve transformuese në institucionin arsimor në përputhje me kontekstin ligjor të arsimit shqiptar**
- **Drejtimi i institucionit në partneritet me prindërit dhe komunitetin e gjerë**